



4838/8

05.06.2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE VLORE

Nr. 1668Akti
Dt.regj.21.09.2015

Nr 1637Vendimi
Date 23.11.2015

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

Sot me date 23.11.2015 Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore e perbere nga gjyqtari **KEN DHIMA**, asistuar nga sekretaria gjyqesore Kamila Petriti, shqyrtoi ne seance gjyqesore me dyer te hapura ceshtjen civile me **nr 1668 Regj**, date 10.09.2015 qe i perket:

PADITES :

Dritan Doraci, i biri i Musa dhe dhe Shqiponja , i datelindjes 09.10.1976 , banues ne lagjen 28 Nentori Berat,I perfaqesuar vete ne gjykim.

I PADITUR :

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat , ne mungese.
Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane, ne mungese.

PERSON I TRETE :

Zyra Vendore e Avokatit te Shtetit Vlore , ne mungese.

OBJEKTI:

Shfuqizim i njoftim vleresimit per detyrim i dates 05.06.2015 i Drejtorise Rajonale te Tatimeve Berat dhe Vendimit date 21.08.2015 te Drejtorise Apelimit Tatimor Tirane qe ka lene ne fuqi njoftim vleresimin e detyrimit, ne baze te nenit 17 /a te ligjit 49/2012 Per Gjykatën Administrative.

BAZA LIGJORE:

Neni 17 /a te ligjit 49/2012 Per Gjykatën



Administrative.

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te zhvilluar me dyer te hapura gjykata pasi degjoi paditesin i cili kerkoi pranimin e padise sipas objektit dhe te perfaqesueses se paleve te paditura e cila kerkoi rrezimin e padise dhe pasi shqyrtoi provat e administruara ne dosje dhe bisedoi ceshtjen ne teresi, si perfundim,

VEREN

Se para Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore paditesi Dritan Doraci ka paraqitur nje padi me objekt si me siper.

Gjykata cmon se ka juridiksion per gjykimin e kesaj ceshtjeje pasi nuk parashikohet ne aktet ligjore e nenligjore ne fuqi ankim ne nje organ me te larte por drejtpersedrejt ne gjykate.

Gjykata cmon se kjo padi eshte ne kompetencen funksionale te kesaj gjykate konform nenit 10 te Ligjit Nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative".

Gjykata cmon se eshte ne kompetencen lendore te kesaj gjykate shqyrtimi i kesaj ceshtjeje pasi padia eshte nje prej atyre te parashikuara ne nenin 7 pika "ç" te Ligjit Nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative".

Gjithashtu gjykata cmon se eshte ne kompetencen tokesore te kesaj gjykate shqyrtimi i kesaj ceshtjeje pasi sipas nenit 11 pika 2 te Ligjit Nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative".

Ne rastin konkret te paditur jane Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane

Nga provat e administruara ne seance gjyqesore rezultoi se Dritan Doraci me Nipt L13218001H, eshte regjistruar ne Drejtorine Rajonale Tatimore Berat me aktivitet privat "Bar-Kafe", me adresë të aktivitetit në lagjen "Iliria" Berat.

Gjykata veren se me ane të Njoftim Vlersimit nr.2528 date 05.06.2015 dërguar nga DRT Berat, subjektit i është komunikuar penalteti në vlerë 250 000 lekë për punonjës të padeklaruar, bazuar në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqiperisë" i nryshuar, neni 119 pika 1 germa b.

Pala paditese e ka ankimuar aktin administrativ për detyrimet tatimore Njoftim Vlersimit nr nr.2528 date 05.06.2015, në Drejtorinë e Apelimit Tatimor Tiranë, e cila me vendimin nr.19480/3 date 21.08.2015 (prot me DRT Berat me nr.3770 date 24.08.2015) ka vendosur: "Lënien në fuqi të aktit administrative Njoftim

Vlersimin për detyrimet tatimore nr.2528 date 05.06.2015 të nxjerrë nga DRT Berat

Gjykata cmon se ligji i zbatueshëm është Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimi nr. 24 datë 02.09.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, VKM-ne nr.753 date 08.09.2010 "Për Bashkpunimin e ISHP me inspitucionet në varësi të Ministris së Financave, Akt-Marveshjes nr.9438/1 date 19.09.2006 "Mbi bashkepunimit të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve" si dhe shkresën e DPT-së nr.9438/6 datë 29.01.2007 "Mbi gjobat për punonjesit e padeklaruar të zbuluar nga Inspektoriat Shtetëror i Punës, Neni 16/1 dhe neni 39 te ligjit nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmareveshjeve Administrative"

Gjykata cmon se vleresimi tatimor është rrjedhojë e penalizimit nga inspektori i Drejtorisë së Përpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave në DRT Berat, në bazë të informacionit të dërguar nga Inspektoriat Shtetëror i Punës në lidhje me një punonjës të padeklaruar për periudhën 2014/12

Subjekti Dritan Doraci ,me Nipt L13218001H është penalizuar me gjobë në vlerën 250 000 lekë për mosdeklarim të fuqise punetore.

Ky penalitet bazohet në proces-verbalin e inspektimit te dates 03.12.2014 mbajtur nga Inspektoriat Shtetëror i Punës dhe shërbimeve shoqërore, dërguar me shkresën nr.254 prot.datë 20.05.2015, protokolluar te ne me nr.259/2 date 26.05.2015 të cilës i janë bashkëngjitur proces-verbali i inspektimit me nr.serie 0004035 date 03.012.2014 dhe vendimi përfundimtar me nr.serie 0016651 date 03.12.2014.

Sipas Proces Verbalit te Inspektimit nr.0004035 date 03.12.2014 dhe Vendimit Përfundimtar nr.0016651 datë 03.12.2014 të inspektorve të Inspektoriatit Shtetëror të Punës është konstatuar se e punësuar Margarita Cimbilli nuk është deklaruar në organet tatimore .

Gjykata verën se nga ana e Inspektoriatit Shtetëror të Punës, është dërguar shkresa me nr.254 prot. date 20.05.2015 (prot.me tonen me nr.259/2 date 26.05.2015) Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat , për të bërë verifikimet e mëtejshme për subjektin Dritan Doraci, me Nipt L13218001H, në lidhje me të punësuarën Margarita Cimbilli

Sipas shkresës së më sipërme të ISHP Berat, dhe në zbatim të Akt-Marveshjes nr.9438/1 date 19.09.2006 "Mbi bashkpunimit të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve" si dhe VKM-se nr. 753 date 08.09.2010 "Për Bashkpunimin e ISHP me inspitucionet në varesi te Ministris së Financave", DRT Berat pas verifikimeve të bëra midis punonjesve të deklaruar në listëpagesë dhe asaj të konstatuar në proces-verbali i inspektimit me nr.serie 0004035 date 03.012.2014 dhe vendimi përfundimtar me nr.serie 0016651 date

03.12.2014, rezulton se e punesuara Margarita Cimbilli nuk ka qënë e regjistruar në organet tatimore ne momentin e kryerjes se kontrollit c'ka ka bërë që subjektit të pemalizohet me gjobë në vlerën 250 000 leke.

DRT Berat në vlersimin e bërë, ka zbatuar VKM-ne nr.753 date 08.09.2010 "Për Bashkpunimin e ISHP me inspitucionet në varësi të Ministris së Financave, Akt-Marveshjes nr.9438/1 date 19.09.2006 "Mbi bashkpunimit të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve" si dhe shkresën e DPT-së nr.9438/6 datë 29.01.2007 "Mbi gjobat për punonjesit e padeklaruar të zbuluar nga Inspektoriatit Shtetëror i Punës"

Në VKM-në nr. 753 date 08.09.2010 "Për Bashkpunimin e ISHP me institucionet në varësi të Ministrise së Financave" shprehet qartësishtë se:

1.Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me Ministrinë e Financave dhe institucionet në varësi të saj.

4. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve,për shkëmbimin e informacionit për subjektet e regjistruara pranë tyre.

5. Informacioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve duhet të përmbajë këto të dhëna:

a) emrin e subjektit;

b) prefekturën;

c) rrethin;

ç) NIPT-in;

d) llojin e veprimtarisë;

dh) adresën e qendrës ose filialit;

e) emrin e punëdhënësit;

ë) numrin e punëmarrësve;

f) numrin e punëmarrësve të deklaruar (të siguruar) në tatime, për çdo subjekt, rast pas rasti, për ndryshimin e numrit të punëmarrësve të deklaruar.

Gjykata verën se mbështetur në VKM-në nr. 753 date 08.09.2010 "Për Bashkpunimin e ISHP me institucionet në varësi të Ministris së Financave" dhe akt marveshjet të nr.488 dt.15.09.2006 te Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe nr.9438/1 dt.19.09.2006 të Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve, hartohet akt marveshje nr.170 prot.datë 13.06.2012 dhe nr.5023 prot.datë 21.06.2012 midis dy Drejtorive Rajonale, të Tatim Taksave dhe Ispektoriatit Shtetëror te Punës Berat.

Ne piken 3 dhe 4 te kesa akt marveshjeje, shprehet se:

3- Drejtoria Rajonale e ISHP Brenda dates 10 te muajit pasardhes dergon ne Drjetorine e Tatimeve listen e subjekteve, te cilat gjate inspektimeve te ushtruara, jane gjetur me te punesuar te padeklaruar shoqeruar per cdo subjekt me dokumentat e meposhtme:

a)Te dhena te plota identifikuese te subjektit si, emir tregetar,perfaqesuesi,lloji I aktivitetit, nipti, adresa e ushtrimit te aktivitetit.

b)Kopjo te process verbalit per te punesuarit e padeklaruar

c)Lista emerore e te punesuarve te padeklaruar ne Drejtorine e Tatimeve

4-Drejtorine e Tatimeve Brenda 2 muajve nga marrja e informacionit sipas pikes 3 njofton Drejtorine Rajonale te ISHP lidhur me futjen ose jo ne skemen e pagimit te kontributeve e te punesuarve te padeklaruar sipas subjekteve

Nga verifikimet e kryera në organin tatimor, është konstatuar se nga ana e subjektit është bërë regjistrimi elektronik për të punësuarën Margarita Cimbillin, por pas kryerjes së inspektimit nga ana e Inspektoriatit Shtetëror të Punës, kjo e konfirmuar nga deklarimi i fuqisë puntore e bërë nga vet subjekti, i cili ka deklaruar fillimin e punës për Margarita Cimbilli me datë 04.12.2014.

Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, ka ndjekur procedurat e mëtejshme ligjore dhe në bazë të verifikimeve të kryera ka nxjerrë aktin administrative, Njoftim-Vlersimi objekt ankimi, me nr.2528 prot.datë 05.06.2015, me anë të së cilit i është vendosur penalitet subjektit për mosdeklarim të të punësuarit në vlerën 250 000leke, bazuar në ligjin Nr.9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i nryshuar ,neni 119 pika 1 germa b, ku shprehet se:

“Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar si më poshtë:

a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh;

b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.”

Si dhe ne Udhezimin nr.24 date 02.09.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise “ ne nenin119/1.

Në zbatim te ligjit nr.9920, date 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”,(i ndryshuar) neni 68 “Vlersimi Tatimor” dhe Udhezimit të Ministrit të Financave nr.24 date 20.09.2008, pika 68.3.1 është përcaktuar se:

“Administrata tatimore ka autoritetin dhe detyrimin per te mbikqyrur gjithë procesin e detyrimeve tatimore te personave te tatueshem”.

Në bazë të dispozitës së sipërcituar administrates tatimore i lind e drejta e kryerjes së vlersimit të detyrimit tatimor i cili depozitohet në informacionet që përmban deklarata tatimore e tatimpaguesit, rezultatet e kontrollit apo menytrat alternative te vlersimit.

Ne zbatim te udhezimit te sipercituar pika 72.1 eshte percaktuar se:

“Në përdorimin e metodave alternative të vlerësimit tatimor administrata tatimore bazohet në dokumentacionin dhe informacionin që disponon, duke pasur parasysh edhe faktet dhe rrethanat konkrete të biznesit, me synim rikarakterizimin e

transaksioneve dhe llogaritjen sa më të saktë të detyrimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi. Të dhënat kryesore ku bazohet gjykimi i administratës tatimore, por pa u kufizuar vetëm në to, janë:

- a) të dhëna direkte nga deklaratat tatimore të tatimpaguesit apo transaksione të tjera të ngjashme të tatimpaguesit;
- b) të dhëna direkte, dokumentacione e informacione të marrë nga palët e treta;
- c) të dhëna, dokumentacione e informacione të marrë nga transaksione të ngjashme të kryera nga tatimpagues të tjerë;
- ç) të dhëna të tjera indirekte, si konsumi energjisë, karburantit, lëndëve të para, normativave të ndryshme, etj...”

Në rastin konkret, DRT Berat ka disponuar të dhënat të vëna në dispozicion nga palët e treta, në rastin konkret informacionin e ardhur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës, ku nga kontrolli i ushtruar në vend biznes është konstatuar puntorja Margarita Cimilli me nr.te sigurimit shoqëror F76028062U. Ne vendimin perfundimtar me nr.serie 0016651 datë 03.12.2014 është lënë si detyrë për tu realizuar “Te futet ne skemen e sigurimeve shoqërore punëemarrësja Margarita Cimbilli menjëher”

Në bazë të udhëzimit nr.24 date 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, neni 119.1.. “Të gjithë tatimpaguesit duhet të deklarojnë në organin tatimor përkates të punësuarit (përfshir dhe punonjesit e papaguar të familjes së personit fizik me të cilët ai punon e bashkjeton ligjerisht), që fillojnë punën për herë të parë të subjektit apo të punësuar rishtazi pranë tij me të dhënat e kërkuara prej secilin prej tyre. Ky deklaram duhet të bëhet të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës së të punësuarve.

Objekti e ka bërë deklarin per punononjësën në po atë ditë që është mbajtur akti inspektimit nga ana e Inspektoriatit Shtetëror të Punës (pas kryerjes së rifikimeve prej tyre) dhe jo një ditë kalendarike më parë sic është parashikuar në lëvizimin e sipercituar.

sa me siper gjykates i duhet te vendose per rrezimin e kërkesë padisë si te bazuar ne prova dhe ne ligj.

Per Keto Aresye

ata bazuar ne Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimi nr. 24 datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 12, “Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe njësive të mosmarreveve administrative”,

VENDOSI

1. Rrezimin e kerkesepadise si te bazuar ne prova dhe ne ligj.
2. Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales paditese.
3. Ndaj ketij vendimi nuk nxirret urdher ekzekutimi.
4. Ky vendim eshte i ekzekutueshem nga Zyra e Permbarimit Gjyqesor menjehere sapo vendimi te marre forme te prere.
5. Ky vendim eshte i formes se prere dhe ndaj ketij vendimi nuk lejohet ankim.

U shpall ne Vlore sot me dt.23.11.2015.

SEKRETARE
KAMILA PETRITI



GJYQTAR
KENDHIMA

